

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të dhëna për shërbimin e kërkuar.

Shërbimi në një vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Gjatë shërbimit të kontrollohet hyrja kryesore dhe në turnin e tretë edhe dera e garazheve.

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

### Kërkesat për zbatimin e shërbimit

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr. 8770, datë 19.04.2001 “Për SHRSF”.

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë të pajisur me armë.

Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta.

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.

c-Grafiku i shërbimit me emrat e personelit përcuditë dhe turn.

d-Mjete ndriçimi në rast mungese energjije elektrike.

e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

### **Specifikimet teknike për sistemin e alarmit**

Specifikat e përgjithshme

Specifikimet e transmetuesit GSM

Sistemi alarmit me karte SIM GSM • built-in GSM module

16 usera (përdorues) për të zhbllokuar alarmin nga ku 4 të jenë administratorë

Te punojë me korent dhe të ketë backup me bateri të rikarikueshme nëse iken korenti.

Te ketë mundësi të lidhet me disa sensore levizje sipas kërkesave të SRD

Te mos ketë limit në nr e alarmeve të marra nga sinjalizuesit.

Sensoret wireless të punojnë deri në 100 metra distance.

Pultet e komandimit te jene me bateri te rikarikueshme dhe te kene rreze rreth 100 metra

Sirena e alarmit tekete rreze afersisht 200 metra.

Temp e operimit -10 deri ne +40 grade °C

## **TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

1. Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

"Ruajtja e ambienteve te Spitalit Rajonal Durres me "Sherbimin e Sigurise Fizike"

2. Objektivat: Të ruajë me perkushtim ambientet që i jane besuar, të ruajë rendin në to si dhe të sigurojë jetën e personelit dhe te pacienteve.

Detyrat:

**Kontraktori ka për detyrë.**

- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t'ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t'ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
- Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast te cënimit të institucionit ose të personelit.
- Shoqeria duhet te marre persiper zhdemtimin 100% te demeve qe vijne per shkak te moskryerjes si duhet te shërbimit nga punonjesit e shoqerise.

**Punonjësi i shërbimit ka për detyrë.**

- Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
- Të zbatojë Rregulloren e Brendshme të Spitalit Rajonal Durres
- Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 15 minuta përpara dorëzimit të turnit.
- Të ruaj me perkushtim objektin që i është besuar, të ruajë rendin në to, si dhe të sigurojë jetën e personelit dhe te pacientit.
- Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa flete-hyrje nga personat te cilët kane te drejte te lëshojnë flete-hyrje.
- Të kerkojë nga shtetasit dhe punonjesit të zbatojnë rregullat e brendshme të Institucionit.
- Punonjesit e shërbimit duhet te plotesojne librin e dorezimit te shërbimit.

- Rojet gjate shërbimit duhet te zbatohen me korektesi te gjitha rregullat dhe etiken e komunikimit.
- Nuk lejohet ndryshimi i grafikut të shërbimit të rojes, pa miratimin e përgjegjësit të shërbimit të rojeve si dhe te vihet ne dijeni pergjegjesi i cili ndjek kontraten.
- Ne rast te largimit te rojeve dhe z/vendesimi i tyre duhet te pasqyrohet me proces verbal emri i ri i cili te dorëzohet tek personi i cili ndjek kontratën.
- Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në këtë objekt.
- Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa flete-hyrje.
- Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjës të tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.
- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjës të rojeve dhe përgjegjës të shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundra zjarrit. Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset, përgjegjës të rojeve dhe përgjegjës të shërbimeve të brendshme të institucionit.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente
- Të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
- Ndalohet futja dhe qëndrimi i rojës në ambjentet e brendshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
- Rojes, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pije alkoolike, të flejë, të bisedojë me persona të jashtëm.
- Të bashkë punojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

Public Health Sector

### **Termet e References per sistemin e alarmit**

Ofertuesi duhet te zoteroje sisteme komunikimi qe perdorin frekuencave qe mbulojne qytetin e Duresit

Shërbimi i monitorimit të sistemit të alarmit të kryhet nga operatori përmes sallës operative.

Sistemi i alarmit të jetë i teknologjisë GSM

Ruajtja e objektit me sistem eletrosinjalizues ne momentin qe eshte i mbyllur.

Vleresim i hapësirës që do të mbulohet me sistem dhe porta/dritare që sigurojnë aksesin në ambjentet që do mbulohen me sistem alarmi.

Vendosja e sensoreve që sigurojnë montim të plote vizual të ambjenteve .

Aktivizim i sistemit me programator. Disponim i pajisjes GSM për transmetim informacioni nga objekti i SRD në sallën operative. Gadishmeri për nderhyrje në momentin e rënies së alarmit brenda 2 minutave.

Shpërndarja:

- Ne total numri i rojeve me tre turne eshte 19.84 roje per 4 vendroje.

- Ne total numri i rojeve me dy turne eshte 3.3 roje per 1 vendroje.

- Ne total numri i rojeve me nje turn eshte 3.3 roje per 2 vendroje.

**Koeficienti per nje vendroje 24 oreshe eshte 4.96 roje per vend roje**

Nr.	Perlllogaritja per 4 vend roje, me 4.96 roje per vend roje per 8 muaj me tre turne	Vlera (Lek)
1	Shpenzime per page baze	
2	Shtese mbi page per turn II	
3	Shtese mbi page per turn III	
4	Shtese mbi page per dite pushimi dhe festash	
	<b>Totali paga + shtesat</b>	
5	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore 16.7%	
6	Tarifa minimale per takse armembajtje, municion, mirembajtje armatimi etj	
7	Shpenzime per uniforme dhe veshmbathje, nderlidhje, fitim si dhe shpenzime te tjera administrative	
	<b>Totali i shpenzimeve per nje roje/muaj</b>	
	Numri i rojeve	
	<b>Totali i shpenzimeve per 19.84 roje/muaj</b>	
	<b>Totali i shpenzimeve per 19.84 roje per 8 muaj</b>	

**Public Health Sector**

II	Perlllogaritja per 1 vendroje me 2 turne, per 8 muaj	Vlera (Lek)
Nr.	Emertimi	Vlera (Lek)
1	Shpenzime per page baze	
2	Shtese mbi page per turn II	
3	Shtese mbi page per turn III	
4	Shtese mbi page per dite pushimi dhe festash	
	<b>Totali paga + shtesat</b>	
5	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore	
6	Tarifa minimale per takse armembajtje, municion, mirembajtje armatimi	
7	Shpenzime per uniforme dhe veshmbathje, nderlidhje, fitim si dhe shpenzime te tjera administrative	

	<b>Totali i shpenzimeve per nje roje/muaj</b>	
	Numri i rojeve	
	<b>Totali i shpenzimeve per 1 vend roje me 2 turne (3.3 roje) per 8 muaj</b>	

<b>II</b>	<b>Perllogaritja per 2 vendroje me 1 turn, per 8 muaj</b>	
<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Vlera (Lek)</b>
<b>1</b>	Shpenzime per page baze	
<b>2</b>	Shtese mbi page per turn II	
<b>3</b>	Shtese mbi page per turn III	
<b>4</b>	Shtese mbi page per dite pushimi dhe festash	
	<b>Totali i shpenzimeve per nje roje/muaj</b>	
<b>5</b>	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetore	
<b>6</b>	Tarifa minimale per takse armembajtje, municion , mirembajtje armatimi	
<b>7</b>	Shpenzime per uniforme dhe veshembathje ,nderlidhje,fitim si dhe shpenzime te tjera administrative	
	<b>Totali i shpenzimeve per nje roje/muaj turni i pare</b>	
	Numri I vend rojeve	
	<b>Totali i shpenzimeve per 2 vend roje me nje turn ( 3.3 roje) per 8 muaj .</b>	

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Spitali Rajonal Durres